



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 761/1 Prot.

Tiranë, më 27/05/ 2021

### V E N D I M

**Nr.87 , Datë 27 /05/ 2021**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr.89 Regj, datë 17.05.2021, paraqitur nga ankuesi F.M, kundër Bashkisë Korçë. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Ankuesi deklaroi se, është banorë i fshatit Kamenicë dhe se në qershor 2019, banesa e tij është shkatërruar nga tërmeti. Në këtë periudhë, ankuesi shpjegon se pranë banesës së tij ka shkuar komisioni i vlerësimit, bashkë me kryeplakun të cilët konstatuan dëmin që kishte pësuar shtëpia.

Pas disa ditësh, ankuesi deklaroi se pranë banesës së tij ka shkuar Kryetari i Bashkisë Korçë, së bashku me administratorin dhe kryetarin e partisë. Sipas ankuesit, Kryetari i Bashkisë pasi kishte parë gjendjen e banesës së tij kishte folur me administratorin për t’ë pajisur ankuesin me leje për prishjen e banesës. Pasi u pajis me lejen për prishjen e banesës, ankuesi deklaroi ka i ka shkuar edhe policia e cila i ka kërkuar që të prishte banesën.

Në këto kushte, ankuesi deklaroi se duke patur besim realizoi prishjen e banesës, ndërkohë që interesohej në mënyrë të vazhdueshme nëse kishte ardhur fondi. Për rreth 1.5 vjet ankuesi shprehet se është interesuar vazhdimisht dhe në momentin që fondi kishte ardhur, ai konstaton se emri i tij nuk ishte i përfshirë, ndërkohë që shokët e tij e kishin.

Ankuesi deklaroi se ka bërë ankesë pranë zyrës përkatëse të Komisionit të Vlerësimit të dëmeve nga tërmeti, pranë Bashkisë Korçë, por ende nuk ka marrë një përgjigje. Ankuesi shprehet se është

---

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

interesuar edhe pranë zyrës së urbanistikës pranë Bashkisë Korçë, të cilët i kanë komunikuar se nuk ka bërë kërkesë, ndërkohë që ankuesi disponon kopje të kërkesës. Sipas ankuesit, zyra e urbanistikës pranë Bashkisë Korçë, i ka komunikuar se duhet të dërgojë dokumentat në Ministrinë e Brendshme se janë ata që merren me këtë punë. Ankuesi deklaron se i ka dërguar dokumentat edhe pranë Ministrisë së Brendshme, por nuk ka marrë përgjigje.

Ankuesi shprehet se, ka bërë ankesë në Portalin e Bashkëqeverisjes, nga ku ka marrë përgjigjen si vijon: *“Zyra e Urbanistikës njofton se qytetari ka njoftuar për dëmtimet nga tërmeti në dt.22.11.2019 dhe kur komisioni ka shkuar për verifikim, objekti i vjetër ishte prishur dhe ishte në përfundim objekti i ri. Komisioni i ndodhur në këto kushte e kishte të pamundur të bënte vlerësimin e dëmeve dhe kjo është arsyeja pse nuk është përfshirë në listën e dëmshpërblimeve”*. Ankuesi ka verifikuar listën e miratuar nga Këshilli Bashkiak, por përsëri emri i tij nuk është përfshirë.

Sa më sipër, ankuesi kërkon nga Komisioneri që përfundimisht të konstatoj faktin e diskriminimit të tij në mënyrë të drejtëpërdrejtë si dhe rimbursimin e dëmit për banesën e tij në bazë të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012 *“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”*.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Nga aktet e administruara rezulton se, ankuesi F.M, ka depozituar pranë Komisionerit ankesën nr.89 regj., datë 17.05.2021, kundër Bashkisë Korçë, në të cilën pretendon se është diskriminuar, pasi nuk ka përfituar kompesim financiar nga ana e bashkisë, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara në banesën e tij, nga tërmeti i datës 01.06.2019, ndërkohë që sipas tij persona të tjerë banorë në të njëjtin fshat, kanë përfituar kompesim financiar për dëmet e shkaktuara nga ky tërmet.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose **është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji**; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dëni për sjelljen diskriminuese”*, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”* Ndërsa në pikën 2, të po këtij neni, parashikohet se: *“Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”*

Referuar parashikimit të nenit 1, marrë së bashku me përkufizimin e diskriminimit, që ligji ka bërë në nenin 3, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Neni 1, i ligjit, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “për çdo shkak tjetër”. Për të vlerësuar nëse pretendimet e ankuesit në lidhje me shkakun e mbrojtur gëzojnë mbrojtje nga parashikimi “*çdo shkak tjetër*”, Komisioneri do të mbajë në konsideratë praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut<sup>2</sup>, në drejtim të interpretimit të shkaqeve/statuseve të tjera sipas nenit 14 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut<sup>3</sup>.

Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, objektive ose personale,

---

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën GJEDNJ.

<sup>3</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KEDNJ.

ose "status", me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri<sup>4</sup>. Gjykata ka theksuar se fjalës "shkak/status tjetër" në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë.<sup>5</sup> Gjykata fillimisht vëren që, ndërsa një numër i shembujve konkretë kanë të bëjnë me karakteristikat që mund të thuhet se janë "personale", në kuptimin që ato janë karakteristika të lindura ose të lidhura natyrshëm me identitetin ose personalitetin e individit, të tilla si seksi, raca dhe feja, jo të gjitha shkaqet e listuara mund të karakterizohen kështu.

Duke mbajtur në konsideratë standartin e mësipërm, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk ka identifikuar një shkak për trajtimin diskriminues, të pretenduar prej tij, pra për faktin që ai nuk ka qenë përfitues i mbështetjes financiare nga ana e shtetit si pasojë e dëmeve të pësuar nga tërmeti i datës 01.06.2019, në raport me personat e tjerë të cilët e kanë përfituar kompesimin e dëmeve financiare të pësuar si pasojë e tërmetit. Për diskriminimin e pretenduar ankuesi duhet të identifikonte një shkak, i cili ka shërbyer si bazë për trajtimin e diskriminues të pretenduar nga prej tij.

Në datën 25.05.2021, me qëllim identifikimin e shkakut mbi bazën e të cilit ankuesi bazon pretendimin e tij për diskriminim, ankuesi u kontaktua nëpërmjet telefonit në numrin e celularit të vendos prej tij si mënyrë komunikimi, në rubrikën e të dhënave të ankuesit, në formularin e ankesës. Nga biseda telefonike e zhvilluar me ankuesin, ky i fundit nuk paraqiti asnjë fakt apo të dhënë tjetër, nëpërmjet të cilave të bëhej e mundur identifikimi i shkakut të mbrojtur.

Bazuar në përkufizimin që ligj i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese. Që një sjellje e paligjshme të konsiderohet si diskriminuese, duhet që ankuesi minimalisht të identifikojë dhe të provojë shkakun e pretenduar. Në ankesën objekt shqyrtimi, ankuesi nuk ka identifikuar një shkak, për të cilin pretendon se është diskriminuar.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pretendimet e ankuesit nuk mund të konsiderohen pretendime për diskriminim, dhe për rrjedhojë ankesa e paraqitur është e papajtueshme me dispozitat e ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar. Bazuar në nenin 32/1/a, të këtij ligji, Komisioneri ka kompetencë të shqyrtojë vetëm ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin "*Për Barazinë Gjimore në Shoqëri*".

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në neni 33, pika 4, gërma "b", të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri arrin në

<sup>4</sup> Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70.

<sup>5</sup> Shih: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “b” të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës Nr.89 regj., datë 17.05.2021, të paraqitur nga ankuesi F.M kundër Bashkisë Korçë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Pa shkak  
Fusha: Shërbime  
Lloji i vendimit: Mospranim